



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 499/8 prot.

Tiranë, më 28. 10. 2024

V E N D I M

Nr. 273, datë 28. 10. 2024

Mbështetur në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 67 Regj., datë 29.03.2024, e subjektit ankues A. K., kundër Qendrës “Çelësi im” dhe Media J-7, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, A. K., parashtron në ankesë se: *“Për shkak të disa problemeve sociale dhe familjare që kam patur gjatë jetës time jam diagnostikuar me çrregullime obsesivo kompulsive e shoqëruar kjo me ankth të shprehur, takikardi, panik, mendime obsesive që ulin përqendrimin dhe reduktojnë aktivitetin. Për këtë gjë jam mjekuar sipas këshillave të mjekut.*

Kam filluar të punoj me kohë të plotë për subjektin “Radio 7” në shkurt të vitit 2007. Nga viti 2007 deri në vitin 2013, kam punuar si:

- 1. Skenariste dhe moderatore e programit “Pse” - i transmetuar në Radio 7;*
- 2. Përkthyes dhe moderatore e programit “Shpresë për ty” - i transmetuar në Radio 7;*
- 3. Gazetare terreni për intervistat e marra për programin “Çelësi im”- i transmetuar në Radio 7;*
- 4. Folëse për programin “Shijoje jetën çdo ditë”- transmetohet edhe sot në Radio 7;*

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

5. *Përkthyes e disa prej programeve të serisë “E vërteta në provëz” - i transmetuar nga Radio 7;*

Nga viti 2014 deri në vitin 2018, kam punuar:

1. *Përkthyes dhe folës për programin radiofonik “Shijoje jetën çdo ditë” - transmetohet edhe sot në Radio 7;*
2. *Gazetare për intervistat që transmetoheshin në Radio 7;*
3. *Dublante e zërit dhe përkthyes e programit “Shijoje jetën çdo ditë” - transmetohet në TV 7;*
4. *Drejtuese e kurseve të rrobaqepësisë të organizuar nga qendra e këshillimit “Çelësi im”*
5. *Përkthyes e serisë me dokumentarë “Udhëtimi” - i transmetuar nga TV 7;*
6. *Përkthyes për programet e shërbesës Sammy Tippit- i transmetuar nga TV 7;*
7. *Përkthyes për programin “Lutu sipas Fjalës” - i transmetuar nga Radio 7;*
8. *Përkthyes e disa prej programeve të serisë me dokumentarë mbi historikun e futbollit - i transmetuar në TV 7;*
9. *Gjetjen e artikujve nga shërbesa të ndryshme televizive, për blogun e Global 7 TV;*

Kontrata e fundit e punës që kam firmosur ka qenë në vitin 2018. Ka qenë me qendrën “Çelësi im” dhe kam punuar si:

1. *Përkthyes programit “Koment për jetën” - transmetohet në Radio 7;*
2. *Përkthyes e programit “Minutë inkurajimi”, që është bashkëpunim i Radio 7 dhe TV 7 me qendrën “Çelësi im”;*
3. *Skenariste dhe regjisore e programit “Super Fëmijët” - i transmetuar në TV 7;*
4. *Përkthim dokumentarësh - të transmetuar në TV 7;*

Nga viti 2021, në bazë të një marrëveshjeje verbale me E. Sh., marrëveshje e konfirmuar edhe në biseda me shkrim, unë kam punuar online dhe kam shkuar në studio një herë në muaj, për regjistrimin e programit “Familja sot”.

Punët që kam bërë gjatë kësaj kohe, janë:

1. *Përkthim i programit “Prekja” – transmetohet në TV 7;*
2. *Redaktim i skripteve të filmit vizatimor “Pishtarët” – transmetohet në TV 7;*
3. *Përkthyes dhe Dublante zëri për programin “Shijoje jetën çdo ditë” - transmetohet në TV 7;*
4. *Përkthim i programit “Moment Vendimtar” - transmetohet në TV 7;*
5. *Përkthim i programit “Rruga” - transmetohet në TV 7;*
6. *Moderatore e programit “Familja sot” - transmetohet në Radio 7.*

Deri në janar të vitit 2018, jam paguar nga Media J-7, edhe nga qendra Çelësi im. Më vonë vetëm nga qendra Çelësi im dhe më kalonin 30 mijë lekë në bankë dhe pjesën tjetër e merrja në dorë, pasi gjatë gjithë periudhës sime si e punësuar nga qendra Çelësi im, puna ime konsistonte në përkthimin e programeve për TV 7 dhe programit “Familja sot” për Radio 7.

Në prill të vitit 2016 në bazë të një bisede me e-mail (e-mail bashkëlidhur), midis E. Sh. dhe K. A., drejtuese e shërbesës CASMI, që bënte kurse rrobaqepësie për gratë e veja në bashkëpunim me qendrën Çelësi im, unë do të paguhesha 4 orë nga Çelësi im dhe 4 orë nga Radio 7. Deri sa

marrëdhënia e këtyre organizatave u shkëput 2 vite më vonë unë kam punuar edhe për qendrën Çelësi im edhe për Radio 7.

Nga viti 2018 e në vazhdim pavarësisht se unë jam paguar nga qendra Çelësi im, kam punuar për programe televizive dhe radiofonike të Media J7 (siç shihet dhe nga lista e mësipërme) gjë që shihet në çdo korrespondencë (e-mail-e e skype) që unë kam patur me E. Sh.

Qendrat e Këshillimit Biblik, “Çelësi im” janë shërbesa më e re e Radio 7. Qendrat do të ofrojnë materiale këshillimi dhe ndërgjegjësimi për më shumë se 100 tema si: Aborti, Vetëvrasja, Abuzimi me Alkoolin dhe Drogat, Zemërimi, Shtatzënia e padëshiruar, Dhuna në familje, Depresioni, Si të sillemi me një të sëmurë me kancer, Si të sillemi me një të sëmurë me sëmundje kronike, Vdekja, Prindërimi, Adoleshentët, Martesa, Këshillimi paramartesor, Takimet e njohjes midis djemve dhe vajzave, Divorci, Vejushat dhe nevojat e tyre, Kultet, Mormonët etj.

Pavarësisht nga emrat, qendrat e përmendur më sipër si Radio 7, TV 7, Media J7 edhe Qendra Çelësi im, janë nën posedimin e të njëjtit person, përkatësisht të E. Sh.

Për shkak të diagnozës time, nga ana e punëdhënësit jam dakordësuar që të punoj nga shtëpia online, ku ja kam dal të plotësoj kërkesat e punëdhënësit.

Në fundin e vitit 2023, pikërisht me datën 12 dhjetor 2023, nga ana e punëdhënëses sime më është ushtruar presion në lidhje me raportet e mija miqësore me një shtetase amerikane, grua zonjë e vjetër në moshë, e njohura jonë e përbashkët, për të cilën më është urdhëruar që duhet të zgjedhësh ose miqësinë me atë ose me punëdhënësen, dhe unë i kam thënë se do të vazhdoj të mbaj lidhje me amerikanen pasi kjo lidhje është e vjetër, dhe nuk ka të bëjë me marrëdhënien e punës që kam me ju. Për shkak të këtij presioni të pavend, dhe këtij arbitrariteti, jam prekur në shëndetin tim dhe jam detyruar të vizitohem te doktori, i cili më datën 19 dhjetor 2023, më ka urdhëruar të pushoj duke më dhënë raport mjekësor, nga data 19.12.2023 – 02.01.2024, me diagnozën për çrregullime të tjera të ankthit.

Gjithashtu, në vijim nga KML me datën 13.01.2024, më është dhënë raport mjekësor nga data 01.01.2024-01.02.2024.

Nisur nga kjo gjendje, si dhe duke shfrytëzuar situatën time shëndetësore, nga ana e punëdhënëses jam urdhëruar që të paraqitem në zyrë, në punë dhe duke shfrytëzuar faktin e sëmundjes time, sepse unë nuk mund të punoj në ambiente me njerëz dhe në ndërveprim me to, prandaj duhej të punoja online nga shtëpia, punëdhënësja më datë 20.12.2023, ora 9:49, më ka urdhëruar nëpërmjet e-mail-it që: “Duke filluar nga momenti që merr këtë e-mail, të lutem të paraqitesh në punë në orarin zyrtar çdo ditë të javës, 8:30 – 16:30. Ky komunikim anulon çdo komunikim të mëparshëm. Po të pres në zyrë për të vazhduar punën si normalisht”.

Pas kësaj e kam vënë në dijeni punëmarrësen me e-mail se jam me raport mjekësor për të cilin ajo ka marrë dijeni. Gjithashtu, më datë 2 janar e kam vënë në dijeni për raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko Ligjor deri në datën 01.02.2024. Familja ime me familjen e punëdhënëses njihen prej kohësh dhe punëdhënësja ka njohuri dhe dijeni në detaje për diagnozën time.

Më datë 01.01.2024, ora 19:40, në rrugë postare, nëpërmjet kolipostës me Nr. RR 564 124 491 AA, më është njoftuar shkresa e qendrës Çelësi im, e nënshkruar nga E. Sh., me subjekt “Komunikim në lidhje me përfundimin e Kontratës së Punës nga ana juaj”, në të cilën thuhet: “Në vijim të komunikimeve tona në lidhje me marrëdhënien e punësimit ndërmjet jush dhe organizatës “Çelësi im” të rregulluara sipas kontratës individuale të punës, nënshkruar në datën 01.02.2018 ndërmjet jush dhe organizatës, duke qenë se ju nuk jeni paraqitur në punë edhe pas përfundimit të raportit

mjekësor që nuk e dorëzuar fizikisht, por e gjetëm në e-Albania, bashkëngjitur nga data 03 janar 2024, ju konfirmojmë se e konsiderojmë kontratën të mbyllur në mënyrë të njëanshme nga ana juaj.

Në përputhje me nenin 156 të Kodit të Punës, kontrata e punës nënshkruar më datë 01.02.2018 nga ana jonë quhet e zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga ju si punëmarrës, në përputhje me pikën 1 të nenin 156, pasi nuk kemi asnjë njoftim nga ju për arsyet e mosparaqitjes në punë nga data 03.01.2024, datë kur ju duhet të ishit kthyer në punë pas përfundimit të raportit mjekësor bashkëngjitur.

Ne e konsiderojmë braktisje të vendit të punës mosparaqitjen tuaj në punë pa asnjë shkak të arsyeshem, të cilin nuk na e keni paraqitur në asnjë lloj forme komunikimi. Ne nuk kemi asnjë njoftim nga ju me shkrim në lidhje me shkaqet e arsyeshme të braktisjes së vendit të punës suaj dhe as ndonjë dorëheqje apo raport për arsyet e mungesës suaj në punë për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune.

Për këtë arsye, sot në datën 12.01.2024 duke e konsideruar braktisje nga ana juaj si punëmarrës vendin e punës dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se në përputhje me pikën 2 të nenit 156 ne nuk do të aplikojmë vlerë dëmi shtesë mbi mungesën tuaj, por thjesht pagën e javës së parë të janarit për të cilën ju nuk jeni paraqitur në punë për të vijuar marrëdhënien normale të punësimit.”

E konsideroj ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përveçse të paligjshme nga pikëpamja e dispozitave të Kodit të Punës, pasi është kryer ndërsa unë isha me raport mjekësor, por edhe në kushtet e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore...

I kërkoj Komisionerit që të shqyrtojë ankimin tim dhe rrethanat e mija duke konstatuar diskriminimin tim në punë për shkak të gjendjes shëndetësore dhe të aftësive të mija të kufizuara, sepse vlerësoj se ndaj meje janë ndërmarrë veprime diskriminuese për shkak të gjendjes time shëndetësore dhe aftësive të mija të kufizuara, duke mu ndërprerë marrëdhënien e punës, pa asnjë arsye, fakt ky i cili vërteton edhe një herë sjelljen diskriminuese ndaj meje.

Në këto kushte, kërkoj rivendosjen e së drejtës së shkelur në mënyrë të paligjshme dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme, duke qenë se diskriminimi ndaj meje është i dukshëm për shkak të gjendjes shëndetësore. Ky diskriminim më ka mohuar të drejtën për punësim.

Sipas ligjit gjendja shëndetësore dhe paaftësia përbën shkak të mbrojtur të diskriminimit të parashikuar nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010. Në rastin tim, shkaku real i ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka qenë pikërisht gjendja shëndetësore e imja e cila është përdorur pas disa vitesh si shkak për të më ndërprerë punën, në pamundësi që unë të punoja në zyrë nga ora 8-16 gjë që ajo (punëdhënësi) e dinte fare mirë prej vitesh këtë fakt”.

Sakaq, A. K. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim e saj nga ana e qendrës Çelësi im dhe Media J-7 për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 1, të LMD përcaktohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/c, të LMD përcaktohet: *“Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 499/2 prot., datë 11.04.2024, i është drejtuar Qendrës “Çelësi im” dhe Media J-7, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Qendra “Çelësi im” dhe Media J-7, përmes shkresave², datë 26.04.2024, informuan Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me parashtrimet e tyre sa i përket ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, duke theksuar ndër të tjera se: *“...Fondacioni “Qendra Çelësi im”, që unë drejtoj nuk ka ushtruar asnjëherë veprimtarinë e vet në formë diskriminuese karshi asnjë punonjësi, asnjë bashkëpunëtori apo edhe pale të tretë. Më lejoni t’ju sqaroj se diskriminimi i asnjë lloj forme nuk ka vend në subjektin që drejtoj.*

² Protokolluar pranë KMD-së me nr. 426/2 prot., datë 19.04.2024.

Së pari, dëshiroj të konfirmoj që A. K. ka qenë e punësuar dhe bashkëpunëtore e jona prej shumë vitesh, nga Maj 2016 deri në Janar të vitit 2024. Gjithashtu, konfirmoj që kemi qenë në dijeni të situatës shëndetësore të diagnostikuar të A. K. në momentin e punësimit të saj me kohë të plotë në maj të vitit 2016 pranë “Qendra Çelësi im” si skenariste, moderatore, përkthyes, gazetare dhe mbikëqyrëse (supervisor) të një projekti humanitar. Sikurse kërkon Kodi i Punës dhe sikurse pohon edhe vetë A. K., edhe pas njohjes me raportet mjekësore që janë dorëzuar gjatë periudhës së punësimit, për gjendjen e saj shëndetësore nga unë si punëdhënës por edhe stafi, A. K. është trajtuar me shumë korrektësi, duke mos e veçuar nga punonjësit e tjerë, pa e diskriminuar në asnjë lloj forme dhe duke përmbushur në çdo kohë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit mbi informacionin për gjendjen e saj shëndetësore. Duke vlerësuar stafin me të cilin punojmë si një nga asetet me të çmuara në punën që bëjmë, kemi përmbushur detyrimin për të krijuar kushte të nevojshme për ambiente pune që stafi të ndihet komod dhe i motivuar për të përmbushur detyrat me të cilat ngarkohen. Në rastin në fjalë, kemi qenë shumë të kujdesshëm që A. K., t’i japim mbështetjen e duhur duke i krijuar ambientin e përshtatshëm në vendin e saj të punës për të respektuar në maksimum nevojat për të patur një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe besoj se edhe ju jeni dakord me ne, që këtë punë e kemi bërë mjaft mirë për sa kohe që A. K. ka qëndruar e punësuar tek ne për një periudhë të konsiderueshme deri në Janar të vitit 2024.

Thënë këtë, pretendimi i ankueses për trajtim diskriminues na duket i pavend, i pavërtetë dhe pambështetur në asnjë provë. Si mund të ndihet e diskriminuar pas më shumë se 7 vitesh, kur ne gjatë gjithë kësaj kohe kemi siguruar (duke qenë në dijeni qysh nga fillimi i marrëdhënies së punës mbi diagnozën e dhënë nga mjekët për A. K.) që ajo të vijonte punën normalisht duke i garantuar një burim të sigurt të ardhurash për veten dhe familjen e saj, por edhe një hapësirë ku ajo të ndihej sa më mirë dhe sa më e barabartë me gjithë kolegët e tjerë? Dhe kjo qasje nuk ka ndryshuar në asnjë moment, për më shumë se 7 vjet.

Për më tej, gjithashtu më lejoni t’ju sqaroj që ndryshimet e ndodhura në lidhje me prezencën fizike në punë të A. K. në periudhën 2021 deri në 2024 kanë qenë ndryshime që nuk kanë ardhur për shkak të gjendjes shëndetësore të A. K., por janë ndryshime që kanë ndodhur për shkak të pandemisë së Covid- 19 dhe të ecurisë së aktivitetit.

Ndryshimi në lidhje me paraqitjen fizike në punë të A. K., sikurse konfirmohet edhe në letrën e saj drejtuar institucionit tuaj, ka ndodhur në vitin 2021, por jo për shkak të situatës së saj shëndetësore, pasi ky ka qenë një fakt i njohur për ne qysh në fillim të marrëdhënies së punës, por për shkak të pandemisë Covid-19, si edhe për shkak se në atë kohë i kishin ardhur për vizitë vajzat e saj që jetojnë jashtë shtetit. Me dëshirën e mirë që A. K. të kalonte më shumë kohë me vajzat e saj iu mundësua të punonte nga shtëpia dhe sa herë të ishte e nevojshme do t’i komunikojë të paraqitej në ambientet e punës për të punuar për aq kohë do të ishte e nevojshme. A. K. ka rënë dakord me këtë ndryshim. Dhe kështu ka ndodhur që A. K., gjatë kësaj periudhe ka qenë prezente në ambientet e punës sa herë që ka qenë e nevojshme shpesh edhe disa herë brenda një muaji. Në asnjë moment, gjatë këtyre viteve nuk ka paraqitur apo bërë të ditur në asnjë formë ndonjë ankese për marrëdhënien e punës, dhe kushtet e punës, përkundrazi ka folur me superlativa për kolegët dhe ambientin jashtëzakonisht komod të punës.

Në përfundimin e pandemisë dhe rivitalizimin e aktivitetit, ka lindur nevoja e prezencës së A. K. në punë, ndaj i është kërkuar të kthehet të punojë fizikisht pranë vendit të saj punës.

Dëshiroj ta theksoj edhe një herë, i është kërkuar të rikthehet në një vend pune ku ka qenë prej 7 vitesh, pra nuk i është kërkuar të bëjë diçka ndryshe nga ajo që bënte më parë. Më duhet ta theksoj sërish se në asnjë moment, nuk kemi marrë nga A. K. asnjë ankesë në lidhje me ambientin e punës, në lidhje me punën me njerëz të tjerë, në lidhje me aftësinë e saj të kufizuar për të punuar në të njëjtin vend pune ku ajo ka pas punuar qysh nga viti 2016 deri në vitin 2021. Në momentin që nevojat e aktivitetit kërkojnë angazhimin, në vijim, në detyra të ndryshme që kërkojnë prezencë fizike të punonjësit është bërë e domosdoshme paraqitja e A. K. në vendin e saj të punës, sikurse të gjithë punonjësit e tjerë. Disa nga këto nevoja për prezencë fizike janë:

- një projekt ku puna është në grup dhe çdo anëtar i grupit duhet të jetë fizikisht në kontakt me anëtarët e tjerë të skuadrës dhe në ambientin profesional të punës për realizimin e detyrës.
- Përkthim simultan në studio profesionale.
- Regjistrime audio në studio profesionale.

Por, siç përmendet edhe në shkresën e A. K., ajo ka refuzuar paraqitjen në punë edhe pse i është kërkuar të vijë të dorëzojë dorëheqjen nëse nuk pranon të rikthehet në kushtet siç ka qenë. I është kërkuar nga ana jonë takim fizikisht për të folur në lidhje me kushtet, për të dëgjuar motivet dhe arsyet pse A. K. papritur nuk dëshironte të paraqitej në punë, por ajo i ka refuzuar këto kërkesa dhe ka vijuar të mos paraqitet në punë dhe më pas kemi marrë dijeni nëpërmjet e-albania për 2 raportet shëndetësore.

Theksojmë këtu që raportet nuk u sollën nga A. K. për të na vënë në dijeni dhe as jemi njoftuar nga kjo e fundit në asnjë formë (e-mail, sms, telefon). Madje njërin nga raportet që A. K. ju ka dorëzuar (datë 13.01.2024) është me datë prapavepruese, pra është marrë nga mjeku në datën 13.01.2024 dhe ka filluar nga data 02.01.2024, pas gati prej 10 ditësh që ne nuk kemi patur asnjë lajm dhe asnjë njoftim nga A. K..

Rrjedhimisht, nisur nga këto kushte, pas pritjes prej më shumë se 10 ditësh që ajo të paraqitej në punë apo të komunikonte me ne, në çfarëdolloj forme të mundshme ne i kemi komunikuar A. K. me anë të një shkrese të dërguar me postë në adresën e saj, përfundimin e marrëdhënieve të punës, duke respektuar të gjitha afatet që parashikon Kodi i Punës.

Edhe pas marrjes në dorëzim të letrës që shpjegon arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, A. K. nuk ka komunikuar në asnjë moment me institucionin tonë.

...në këtë situatë të krijuar vetëm për shkak se A. K. iu kërkuar të paraqitet në vendin e saj të punës në oraret normale të punës, na duket e padrejtë që të akuzohemi për diskriminim për sa kohë që nuk gjendet asnjë bazë që të lidhet me diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore të A. K..

Nuk është ushtruar asnjë e lloj presioni ndaj saj, përkundrazi i është kërkuar qetësisht në mënyrë shumë korrekte me e-mail siç e konfirmon edhe ajo vetë që të paraqitet në punë. Do rikthehej në një vend ku ajo ishte ndjerë komode dhe profesionalisht mirë për sa kohe që nuk është larguar për më shumë se 7 vjet dhe për sa kohë që nuk kërkoj ajo të largohej të punonte nga shtëpia në vitin 2021, por e vendosëm ne për të mirën e shëndetit të të gjithë punonjësve, për shkak të pandemisë dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi në atë periudhë. Në kushtet kur ky rrezik është tejkaluar dhe për shkak se nevojat e aktivitetit e kërkojnë që A. K. duhet të paraqitet në punë njëjloj si gjithë punonjësit e tjerë, na duket e pavend dhe fyese që të përflitemi si diskriminues nga

ana e saj, në sytë e institucionit tuaj, kur i gjithë misioni i punës sonë nuk mundet as ta imagjinojë një veprim të tillë në asnjë lloj forme... ”.

Sa i përket Media J-7, u sqarua ndër të tjera se: “Dëshirojmë që së pari t’ju falënderojmë për shkresën tuaj dhe për përshkrimin e detajuar të ankesës së mbërritur pranë agjencisë suaj me Nr. 67, datë 29.03.2024 nga ana e A. K..

Më lejoni t’ju sqaroj se marrëdhënia e punës e A. K. me Media J-7 subjektin që unë drejtoj ka përfunduar në 31.01.2018 me dorëheqjen e saj gati 6 vjet më parë. Dokumentin e gjeni bashkëngjitur kësaj letrë... ”.

2. Në këto kushte, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 13.05.2024, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e Media J-7 dhe Qendrës “Çelësi im”.

Në përgjigje të këtij e-mail-i ankuesja, me e-mail-in datë 14.05.2024, informoi Komisionerin lidhur me qëndrimet ndaj Qendrës “Çelësi im”, se: “E. Sh. cilëson se unë kam filluar punë me kohë të plotë për Qendrën Çelësi im, në maj të vitit 2016, ndërkohë që në letrën e saj për pushimin tim nga puna, shkruan se kontrata me këtë qendër, është firmosur në datën 1.2.2018. Gjithashtu, punët që E. Sh. ka renditur, por edhe shumë të tjera, janë për Media J-7 dhe për Media 7 Ballkan, dhe nuk kanë asnjë lidhje me Qendrën Çelësi im, që është qendër këshillimi. E. Sh. mund t’i ndryshojë kontratat, apo emërtimet e bizneseve, por faktet janë fakte.

E. Sh. thotë se unë jam trajtuar me korrektësi , pa u diskriminuar në asnjë lloj forme dhe se unë kam punuar për të, për një periudhë kohe të konsiderueshme. Më pas, thotë se kjo situatë është krijuar nga zonja Kopani. Ju siguroj se, pas 17 vitesh punë dhe në moshën 50 vjeçare, nuk do të shkaktoja një situatë të tillë, kaq të dëmshme për shëndetin tim!

E. Sh. pretendon se më ka garantuar një burim të mirë të ardhurash për vete dhe për familjen time. Më vjen mirë që ajo e mendon të mjaftueshme, për një familje, shumën prej 55 mijë lekësh në muaj, pas 17 vitesh punë. (Dua të theksoj këtu, që unë jam nënë e divorcuar dhe kam prindërit mbi 70 vjeç, për të cilët duhet të kujdesem financiarisht).

E. Sh. thotë se, ndryshimet e ndodhura në lidhje me prezencën time fizike në punë, nga viti 2021, deri në vitin 2024, kanë qenë për shkak të Covid-19, ndërkohë që në vitin 2021, njerëzit iu kthyen punës normalisht, në zyrë. Unë vazhdova të punoj nga shtëpia, vetëm ngaqë isha më e qetë dhe më produktive.

E. Sh. deklaron se puna ime online, ka patur lidhje me ardhjen e vajzave të mia për pushime. Ju garantoj se ardhja e vajzave të mia, për vetëm një muaj në vit, nuk ka të bëjë aspak me punën time online. Unë kam bërë të njëjtën sasi pune, madje edhe më shumë. Pra, kjo lidhet pikërisht me produktivitetin tim, gjë që i ka interesuar shumë E. Sh.. Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të bisedës sonë në skype, që vërteton se puna ime nga shtëpia, ka të bëjë vetëm me sasinë dhe cilësinë e punës që bëja.

E. Sh. thotë se më ka kërkuar të paraqitem në zyrë, për shkak të punës në grup, përkthim simultan në studio profesionale dhe regjistrime audio në studio profesionale. Ndërkohë, në asnjë e-mail, komunikim në skype apo në telefon, nuk më ka njoftuar se unë do të bëja një punë tjetër, përveç përkthimeve që bëj nga shtëpia, dhe paraqitjes një herë në muaj, për regjistrimin e programit “Familja sot”. Për më tepër, ajo vetë ka deklaruar se unë kam dhënë “dorëheqjen nga

pozicioni i spikeres”. Kërkesa e E. Sh. që unë të paraqitem në zyrë, ka qenë presion që unë të jepja dorëheqjen, për shkak të bisedës së datës 12.12.2023 (të cilën ajo nuk e ka mohuar) dhe të komunikimeve me e-mail që kanë vijuar më tej. Bashkëngjitur do të gjeni të gjitha këto komunikime.

E. Sh. pretendon: “I është kërkuar nga ana jonë takim fizikisht për të folur në lidhje me kushtet, për të dëgjuar motivet dhe arsyet pse A. K. papritur nuk dëshironte të paraqitej në punë, por ajo i ka refuzuar këto kërkesa dhe ka vijuar të mos paraqitet në punë...” Në asnjë mënyrë apo formë, nuk më është kërkuar kjo gjë, por më është kërkuar të harroj të gjitha bisedat e mëparshme dhe se më mirëpresin në punë në datën 3.1.2024. I vetmi komunikim që kemi patur, që nga data 12.12.2023, kanë qenë e-mail-et që provojnë qartë presionin e saj, në vazhdimësi të presionit që më bëri në datën e mësipërme, për të zgjedhur midis punës në Radio 7 dhe miqësisë sime me K. A.. Bashkëngjitur do të gjeni e-mail-et.

Gjithsesi, ankesa ime për diskriminim nga ana e E. Sh., nuk ka të bëjë as me vitet e punës, as me pagesën, dhe as me mënyrën se si jam ndjerë e jam trajtuar unë në vendin e punës. E. Sh. më ka pushuar nga puna, kur unë kam qenë me raport të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor, për çrregullime të ankthit (të shkaktuara vetëm prej saj). Qeveria shqiptare ka bërë të mundur që raportet mjekësore të mos jepen më fizikisht, por përmes sistemit e-Albania. Dhe unë, megjithëse isha shumë e sëmurë për të lexuar e menduar, u sigurova për këtë, duke kërkuar në internet, ku lexova se raporti i shkon njëkohësisht edhe punëmarrësit, edhe punëdhënësit. Bashkëngjitur do të gjeni fotot e rezultateve të kërkimeve të mia.

E. Sh. deklaroi se i duket e pavend dhe fyese që të përflitet si diskriminuese, pa menduar se sa e pavend, fyese, mendërisht dhe emocionalisht shkatërruese, ka qenë sjellja e saj kundrejt meje. Unë kam punuar me përkushtim, integritet, përgjegjshmëri dhe shumë përulësi. Kam bërë çdo gjë që më është kërkuar nga E. Sh. me dhe pa pagesë, të shtunë dhe të dielë, në orarin e punës dhe jashtë orarit të punës, pavarësisht se çfarë përmbante apo nuk përmbante kontrata e punës. Si një besimtare e krishterë, kontrata ime me E. Sh., ka qenë një kontratë morale dhe pikërisht kjo gjë, më ka nxitur të punoj me ndershmëri dhe përkushtim, pa menduar kurrë se mund të gjendesha në një situatë të tillë”.

Sa i përket qëndrimit të mbajtur ndaj përgjigjes së Media J-7, A. K. sqaroi se: “Shkresën që E. Sh. e ka paraqitur si dorëheqjen time nga pozicioni si “spikere”, e konsideroj të parregullt, për këto arsye:

1. Duke vënë re gabimet e shumta drejtshkrimore, nuk ka asnjë mundësi, që këtë shkresë ta kem shkruar unë.
2. Si njohëse e mirë e Gjuhës Shqipe dhe në përpjekje për të përdorur çdo fjalë në përputhje me fjalorin e saj, unë nuk e përdor kurrë fjalën “spikere”. Në vend të saj, gjithmonë kam përdorur dhe përdor fjalën “folëse”.
3. Nuk ka asnjë datë të vendosur në krye të shkresës.
4. Nuk e kuptoj se si kontrata është lidhur në datën 1.09.2017 dhe dikur në dhjetor 2017, unë papritur, kam vendosur ta ndërpres kontratën.
5. Nëse unë kam dhënë dorëheqjen nga pozicioni i folëses, ku sipas shkresës kam punuar nga 1.9.2017, deri në dhjetor 2017, përse duhet të lajmëroja një muaj para shkëputjes, dhe jo dy javë, siç e përcakton Kodi i Punës.

6. *Ndërkohë që unë jam paguar nga Media J-7 41100 lekë dhe nga Qendra Çelësi im 46400 lekë (sipas tabelës së kontributeve që do ta gjeni bashkëngjitur), përse duhet të jepja dorëheqjen nga Media-J-7 dhe të kisha më pak të ardhura.*
7. *Nëse unë do të kisha “shkaqe personale” sipas shkresës, pse do të punoja në të njëjtin vend dhe me të njëjtin njerëz, me një rrogë shumë më të ulët.*
8. *Nuk e kuptoj pse duhet të jepja dorëheqjen si folëse, kur edhe pas kësaj date, unë kam vazhduar të jem folëse për programet “Familja sot” dhe “Shijojë jetën çdo ditë”, të cilat mund t’i verifikoni lehtësisht në youtube.*

<https://www.youtube.com/watch?v=92Buhn6d4DM>

<https://www.youtube.com/playlist?list=PLfBDdU2eP5y-ex6lfDbISAAVVw886MXgo>

9. *Në deklaratën e Bankës Kombëtare Tregtare, me datë 27.02.2024, foton e së cilës do ta gjeni bashkëngjitur, tek emërtimi i llogarisë shkruhet: A. M. K. - paga Media J-7 Shpk. Duke qenë se unë nuk kam asnjë kopje origjinale të kësaj shkrese që nuk ka datë, madje as të kontratës nga e cila kam dhënë dorëheqjen, do të doja që E. Sh. të vinte në dispozicionin tuaj:*
 - *kopjen origjinale, ose të legalizuar nga noteri publik, të kontratës me Media J-7 (që ju i keni kërkuar),*
 - *kopjen origjinale, ose të legalizuar nga noteri publik, të shkresës që unë kam dërguar,*
 - *kopjen origjinale, ose të legalizuar nga noteri publik, njoftimin që E. Sh. e ka marrë dhe e ka pranuar dorëheqjen time. ”.*

3. *Në vijim të shqyrtimit të ankesës, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenin 40, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 499/5 prot., datë 13.06.2024, vendosi të realizojë një seancë dëgjimore, më datë 25.06.2024 dhe ftoi palët në proces të marrin pjesë për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.*

Në përgjigje sa më sipër, me e-mail-in datë 19.06.2024, Qendra “Çelësi im” njoftoi Komisionerin dhe kërkoi që seanca dëgjimore të realizohet në një datë tjetër për shkak të pamundësisë për të qenë prezent në datën e caktuar.

4. *Në këto kushte, Komisioneri me shkresën nr. 499/6 prot., datë 24.06.2024, njoftoi palët për realizimin e seancës dëgjimore më datë 08.07.2024, ora 10:00. Gjithashtu, përmes kësaj shkrese u kërkua nga palët në proces të vihet në dispozicion të Komisionerit, ditën e realizimit të seancës dëgjimore informacioni si më poshtë:*
 - *Informacion dhe argumente lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e A. K., në e-mail-in përcjellë Komisionerit më datë 14.05.2024 (të cilin po ua kemi vënë në dispozicion bashkëngjitur shkresës nr. 499/5 prot., datë 13.06.2024).*
 - *Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me A. K. (procesverbale, aktin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, njoftime etj).*
 - *Informacion mbi arsyet që A. K. i është kërkuar të punojë në zyrë, kur sipas saj, për një periudhë të gjatë ajo ka punuar online nga banesa e saj.*

- Kopje të kontratave të punës së lidhur me A. K. dhe qendrës “Çelësi im” dhe Media J-7.
- Informacion dhe prova (nëse ka), sa i përket pretendimit të A. K. se ka vënë në dijeni përmes e-mail-it E. Sh. mbi gjendjen shëndetësore të saj dhe faktin që ka qenë me raport mjekësor të lëshuar nga KML për periudhën 01.01.2024-01.02.2024.
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Mbështetur në njoftimin e bërë, seanca dëgjimore u zhvillua më datë 08.07.2024, në praninë e palës ankuese, si dhe në praninë e përfaqësuesve me autorizim të Qendrës “Çelësi im”, shtetaseve: S. SH. dhe M. K., anëtare e Bordit të Qendrës “Çelësi im”.

Palët i qëndruan të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura në ankesën e parashtrimet e depozituara prej tyre para KMD-së, të cilat do të analizohen edhe në vijim të arsyetimit të këtij vendimi.

Në vijim ankuesja shtoi ndër të tjera se përmes një bisede të zhvilluar në aplikacionin Skype, duke ditur gjendjen shëndetësore të saj, E. Sh., e ka lejuar të ushtrojë punën e saj nga shtëpia. Pas debatit të zhvilluar me datë 12.12.2023, E. Sh. i ka kërkuar të kthehet dhe të punoj nga ambientet e punës/zyrës. Në vijim, nga data 19.12.2023 ankuesja thekson se është trajtuar me raport mjekësor, deri më datë 01.02.2024. Në datën 18.12.2023, ankuesja theksoi se E. Sh. i ka dërguar e-mail, ku i ka kërkuar ndjesë me idenë që janë keqkuptuar. Në përgjigje të saj, ankuesja i ka sqaruar me e-mail se në bazë të bisedës që kanë bërë në datën 12 dhjetor, ku është vendosur përpara një zgjedhje mes E. Sh. apo shtetases amerikane, ajo nuk pranonte të punonte më për të. Në përfundim i ka theksuar se pavarësisht se nuk ka dëshirë të largohet nga puna, nuk është në gjendje më të punojë për E. Sh. dhe i ka kërkuar të plotësojë dokumentacionin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Pas këtij momenti, përmes e-mail-it datë 20.12.2023, duke qenë se ankuesja nuk ka patur dëshirë të largohej nga puna, E. Sh. i ka kërkuar që në vijim ajo të paraqitej në punë sipas orarit zyrtar. Sipas ankuses, fakti që i është kërkuar që në vijim të punojë në zyrë, për të ishte një formë presioni për të dhënë dorëheqjen.

Ankuesja gjatë seancës theksoi se, shkaqet e diskriminimit të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar i lidh me faktin që është larguar nga puna gjatë periudhës që ka qenë me raport mjekësor dhe i është kërkuar të punoj nga zyra, pavarësisht se punëdhënësi e ka ditur gjendjen shëndetësore të saj.

Nga ana e përfaqësueses së Qendrës “Çelësi im”, u theksua se në momentin që i kanë kërkuar ankuses të paraqitet në punë, ajo i është përgjigjur duke i sqaruar se duhet të kontrollojnë e-albanian pasi ajo është me raport mjekësor. Sipas tyre, pasi është kontrolluar e-albania, ku kanë konstatuar që ajo ishte me raport mjekësor deri më datë 02.01.2024, i kanë uruar të shkuara dhe i kanë kërkuar takohen më datë 03.01.2024. Në vijim, përfaqësueset e qendrës kanë pranuar përmbajtjen e bisedës së zhvilluar mes ankuses dhe E. Sh., por diskutimi për të vendosur mes saj dhe zonjës amerikane, lidhej me marrëdhëniet e punës. Kjo pasi, E. Sh. kishte konstatuar që ankuesja po punonte për zonjën amerikane dhe për këtë arsye i kishte kërkuar të vendoste nëse do të punonte për të apo për zonjën amerikane. Biseda sipas tyre lidhet vetëm me marrëdhëniet e punës dhe jo me ato personave mes ankuses dhe E. Sh..

Nga data 03.01.2024-13.01.2024, sipas përfaqësuesve të qendrës, pasi kanë kontrolluar e-albanian, si dhe duke qenë se nuk kanë patur asnjë njoftim, kanë vijuar me procedurën e ndërprerjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës për shkak të braktisjes së punës, për më shumë se 7 (shtatë) ditë nga ana e ankueses. Raporti i pretenduar nga ankuesja sipas tyre, është gjeneruar në sistemin e-albania në datën 13.01.2024, në fund të ditës dhe për këtë arsye ata nuk kanë patur dijeni më parë.

Sa i përket, shtetases amerikane, përfaqësueset e qendrës theksuan se ajo ka një organizatë të vetën dhe sipas tyre, bazuar në disa publikimeve (news letter) të bëra nga ana e saj, kanë konstatuar që ankuesja ka marrë pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga organizata që ajo drejton. Për këtë arsye, nga ana e E. Sh. i është kërkuar të zgjedh të punojë me Qendrën “Çelësi im” apo organizatën e zonzës amerikane.

Gjithashtu, nga ana e përfaqësuesve të qendrës u theksua se që nga data 12.12.2023 e në vijim, nga ana e ankueses nuk është dorëzuar asnjë përkthim apo punë e bërë. Në vijim, në kushtet që nuk kishin një njoftim nga ana e ankueses nëse ishte me raport, nga ana e qendrës ishte menduar që nuk do të rikthehej më në punë dhe më datë 13.01.2024, i ishte dërguar shkresa për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Në përfundim, A. K. pranoi faktin që nuk e ka njoftuar punëdhënësin lidhur me faktin që ajo vijonte të ishte me raport mjekësor dhe nga data 12.12.2023 e në vijim ajo ka punuar nga shtëpia por nuk ka dorëzuar asnjë material pranë punëdhënësit.

5. Pas seancës dëgjimore me shkresën³ datë 07.08.2024, Qendra “Çelësi im” informoi Komisionerin ndër të tjera se:

“1...Dëshirojmë t’ju kërkojmë vëmendjen tuaj për Nenin 8 (të Kontratës së Punës) ku parashikohet edhe motivi i diskutimit të nisur mes A. K. dhe E. Sh. ku “punëmarrësi ka rënë dakord që gjatë periudhës së punësimit të mos punojë për asnjë subjekt tjetër konkurrent dhe madje as të mos shpërndajë informacion qoftë edhe në mënyrë “miqësore” tek palë të treta”.

Gjithashtu edhe nëse vëreni ditët e punës të përcaktuara në kontratë janë 5 dhe ambientet e punës ku duhet të paraqitet punëmarrësi janë pikërisht ambientet e punëdhënësit. Kësaj kontrate aneksi i vetëm që i është bërë është ai për ndryshimin e pagës dhe nuk ka asnjë aneks tjetër në lidhje me punën nga shtëpia. Edhe aneksin e gjeni bashkëngjitur.

2. Po dërgojmë edhe vetëdeklarimin e dakordësuar në lidhje me punonjësit e qendrës. Asnjëri prej tyre nuk punon më nga shtëpia apo qoftë edhe në formë hibride. Pra, nuk kemi asnjë diskriminim ndaj A. K. për ti kërkuar vetëm asaj të paraqitet fizikisht në punë.

3. Do të gjeni bashkëngjitur 2 publikime elektronike (newsletter) të muajit Maj 2024 dhe muajit Dhjetor 2023 të publikuara nga qendra CASMI. Në publikimin e muajit Dhjetor, ka foto të A. K. me përfaqësues dhe punonjës të ndryshëm të CASMI.

Gjithashtu në newsletter e muajit Maj 2024 A. K. i referohen si përkthyes (faqja 3) ku në gjuhën angleze thuhet që kërkohej fonde për ta paguar A. K. për përkthimin & redaktimin e një libri. Ndërkohë që A. K., siç e keni edhe ju në regjistrimin audio të seancës dëgjimore konfirmoi

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1145 prot., datë 08.08.2024.

që nuk punon dhe është e papunë.

Gjithashtu në rrjetet sociale të TWR Albania në Instagram, Facebook dhe YouTube ka postime të shumta, fotografi, programe audio dhe video, të A. K. gjatë vitit 2024 që tregojnë që ajo është aktive në këtë organizatë në përkthime eventesh apo moderime të ndryshme në studio apo në grupe personash.

Së fundmi, referuar e-mailit që morëm nga ju për informacionin e dërguar nga A. K. vërtetohet edhe një herë ajo që ne sqaruam në seancë. A. K. nga data 12.12.2023 i ka ndërprerë të gjitha komunikimet dhe që nga dt. 05.12.2023 nuk ka dorëzuar asnjë punë me email. Është e vërtetë që materialet e dërguara në nëntor ishin për periudha të mëvonshme, por puna që i ishte kërkuar të bëhej në dhjetor nuk është dërguar dhe nuk është kryer asnjëherë pavarësisht se në cilën periudhë do publikohet.

Edhe screenshot i bisedës në SKYPE daton 1 Shtator 2023 dhe jo 5 dhjetor 2023. Në shtator kur A. K. ka kërkuar të punojë nga shtëpia ka marrë konfirmim për P0, ndërkohë që në Dhjetor është kërkuar verbalisht dhe me e-mail të kthehet në punë, fizikisht dhe nuk ka pranuar.

Pra me çdo informacion që ka sjellë A. K. është lehtësisht e vërtetueshme ajo që është diskutuar në seancën dëgjimore për përfundimin e një marrëdhënie pune jo për shkak diskriminimi, por për shkak të braktisjes së vendit të punës.

Si rrjedhojë, do ju luteshim që të merrni në konsideratë pushimin e këtij ankimimi për sa kohë që në asnjë moment dhe në asnjë veprim nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të gjendjes së A. K....”.

6. Në këto kushte, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 08.08.2024, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e Qendrës “Çelësi im”.

Në përgjigje të këtij e-mail-i ankuesja, me e-mail-in datë 09.08.2024, informoi Komisionerin lidhur me qëndrimet ndaj Qendrës “Çelësi im”, duke theksuar ndër të tjera se: “Dua të sjell vëmendjen tuaj faktin që E. Sh., në asnjë përballje nuk paraqitet personalisht, por delegon persona me të cilët nuk na lidh profesioni, nuk dinë asgjë për marrëdhëniet dhe bisedën time me E. Sh. dhe, për më tepër, nuk dinë asgjë për punën që unë kam bërë.

Unë kam besimin se kam qenë mjaftueshëm e qartë në përcjelljen e situatës sime, ku haptazi, jam diskriminuar nga punëdhënësja ime, duke më pushuar në pikën time më të ulët psikologjike dhe emocionale, madje duke qenë ajo shkaktare për këtë pikë. Gjithashtu, besoj shumë që ju e keni kuptuar çështjen time, ashtu siç është në të vërtetë.

Ju lutem, kini parasysh se unë çështjen time e parashtrova në seancën e dëgjimit dhe në komunikimet e ndërsjellta gjatë kësaj kohe, duke ju vënë në dispozicion çdo informacion dhe dokument të kërkuar prej jush. Sinqerisht, po mendoja se në komunikimin e fundit, do të gjeja përgjigje profesionale, të detajuara dhe korrekte, të kërkesave që ju i keni parashtruar E. Sh.. E zhgënjyer, por jo e habitur, vura re që përsëri E. Sh. vazhdon me këmbëngulje, strategjinë e fjalëve bulevarde “më the; të thashë”. E përsëri, e nisur nga integriteti im personal dhe si një e krishterë e mirë, unë po vazhdoj të reagoj dhe të përgjigjem, edhe pse fare mirë, reagimi im mund të ishte shumë i thjeshtë: heshtje dhe ngulmim që E. Sh. të paraqesë dokumentet që ju i kërkonin dhe që ajo vazhdimisht i shmang. Gjithashtu, para se E. Sh. të sjellë dokumente të shpikura dhe pa asnjë lidhje me kërkesat tuaja, duhet të shpjegojë pse solli një dokument të

falsifikuar, sikur unë kam dhënë dorëheqjen si “spikere”, dokument që shumë shpejt, do të jetë subjekt i kallëzimit në prokurori? Një person që falsifikon dokumentet, apriori, nuk mund të jetë i besueshëm në asnjë lloj pretendimi tjetër. Kërkoj nga ju që kjo të merret parasysh. Gjithsesi, në një letër bashkëngjitur këtij e-mail-i, po ju paraqes përgjigjet e mia dhe vazhdoj të jem e hapur dhe e disponueshme, për t'iu përgjigjur çdo kërkesë që ju keni.

Kam besim të plotë në vendimarrjen tuaj të drejtë, por mbi të gjitha, kam besim tek Zoti që më udhëheq në rrugë të drejtë dhe të virtytshme...”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “ “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës,*

shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Nga informacioni fillestar i paraqitur në ankesë, u konstatua që ankuesja pretendonte diskriminim vetëm ndaj Qendrës “Çelësi im” dhe Media-s J-7. Në analizë të parashtrimeve të saj, u konstatua se ankuesja kishte si subjekt diskriminimi edhe Administratoren e Qendrës “Çelësi im” dhe Media J-7, E. Sh..

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit ankues, (të depozituara në ankesën me nr. 67 regj., datë 29.03.2024, pranë KMD-së) Komisioneri vlerësoi se objekt i gjykit të analizës të kësaj vendimmarrje, janë ato pretendime mbi bazën e të cilave janë investuar palët gjatë shqyrtimit të ankesës, dhe *për e mbi* të cilat ka vijuar procedura hetimore, kundrejt subjekteve për të cilat ka pretenduar se e kanë diskriminuar, Qendra “Çelësi im”, Media J-7 dhe E. Sh. në cilësinë e Administratores së këtyre subjekteve, duke konsideruar se edhe shkaqet për të cilat ka pretenduar trajtimin e padrejtë e të pafavorshëm, i lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë me këto dy subjekte.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se të gjitha pretendimet që nuk janë objekt i ankesës me nr. 67 regj., datë 29.03.2024, nuk do të jenë objekt i analizës së këtij vendimi.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara, të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për punësim në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

A. 1. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja nga ana e Media J-7.

Mbështetur në Ekstraktin Historik të shkarkuar nga regjistri i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton që subjekti me përgjegjësi të kufizuar “Media J-7”, është i regjistruar me numër unik (NUIS) K.....F dhe është themeluar më datë 25.06.2001, me Administratore E. Sh..

Objekti i aktivitetit të këtij subjekti është: *“Drejtimi i Radios, Televizionit lokal dhe i mjeteve radiofonike, televizive, lokale, mirëmbajtja, riparimi, instalimi, montimi i makinave dhe aparaturave elektronike dhe elektrike të telekomunikacionit në funksion të veprimtarisë së shoqërisë”.*

Referuar dokumentacionit dhe informacionit të administruar nga palët në proces, gjatë shqyrtimit të ankesës përmes shkresës datë 26.04.2024, Media J-7 parashit se marrëdhënie e punës mes tyre dhe A. K., ka përfunduar më datë 31.01.2018 me dorëheqjen e saj. Lidhur me këtë, Media J-7 vuri në dispozicion të Komisionerit shkresën datë 01.12.2017, përmes së cilës A. K. informon ndër të tjera Media-n J-7 dhe administratoren e saj, E. Sh., duke i sqaruar se: *“Nëpërmjet kësaj letre, ju bëj me dije që për shkaqe personale heq dorë nga pozicioni si spikere, sipas kontratës së punës së datës 07.09.2017 dhe për këtë qëllim ju njoftoj që duke filluar nga data 31.01.2018 kontrata e punës e lidhur ndërmjet meje dhe shoqërisë Media J-7 do të konsiderohet e zgjidhur”*.

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, në nenin 12 të tij parashikon se: *“Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit”*.

Në nenin 21 *“Forma e Kontratës së Punës”*, të Kodit të Punës, parashikohet se:

“1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

2. Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës...”

Në analizë sa më sipër, për të formalizuar një marrëdhënie punësimi mes një punëmarrësi dhe një punëdhënësi, duhet të ekzistojë Kontrata e Punës e lidhur mes palëve, e cila mund të jetë në formë të shkruar ose jo. Për të provuar që lidhjen e një marrëdhënie punësimi, punëmarrësi duhet të pranojë të kryejë një shërbim apo detyrë kundrejt pagesës. Pra, duhen përmbushur disa element të rëndësishëm, si p.sh.: kontrata e punës së lidhur mes palëve, pagesat e përfituara nga ana e punëmarrësit etj.

Në rastin konkret, subjekti ankues ka pretenduar përpara Komisionerit se edhe pas datës 31.01.2018, ajo ka vijuar marrëdhëniet e punësimit me subjektin Media J-7, duke i vërtetuar këto pretendime përmes një cikël emisionesh radiofonike të publikuara në kanalën Youtube, me temë *“Familja sot”*. Gjithashtu, ankuesja ka vënë në dispozicion të Komisionerit, një shkresë të marrë nga Banka Kombëtare Tregtare *“Konfirmim i Llogarisë Bankare”*, në përmbajtje të së cilës, citohen të dhënat dhe numri i llogarisë së saj, si dhe ndër të tjera tek Emërtimi i Llogarisë citohet: A. M. K. -Paga Media J-7 shpk. Nga këqyrja e këtij dokumenti provohet se emërtimi i numrit të llogarisë është A. M. K. -Paga Media J-7 shpk, por jo se ankuesja ka përfituar të ardhura mujore nga subjekti Media J-7.

Gjithashtu, pavarësisht konstatimit të materialeve të publikuara në kanalin Youtube, nga ana e palëve në proces nuk u vërtetua se mes Media J-7 dhe A. K. ka patur një marrëdhënie punësimi të lidhur nëpërmjet një kontrate pune apo ankuesja të ketë përfituar pagesë mujore nga ky subjekt për një punë të kryer.

Referuar provave të administruara rezulton që ankuesja përmes kërkesës datë 01.12.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punësimit me subjektin Media J-7, përmes dorëheqjes që në datën 31.01.2018.

Për sa më sipër, Komisioneri, bazuar në nenin 33, pika 4/ç e LMD-së, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse:...ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”*, gjykon se ky pretendim i ankueses për diskriminim nga ana e subjektit Media J-7, nuk mund të pranohet për shqyrtim pasi është haptazi e pabazuar.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushet kriteri ligjor për pranimin e pretendimit për diskriminim kundër subjektit Media J-7, pasi nuk ekzistojnë elementët që provojnë se mes ankueses dhe subjektit Media J-7 ka patur një marrëdhënie punësimi e cila është zgjidhur dhe për këtë arsye ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit.

A. 2. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja nga ana e Qendrës “Çelësi im”.

Mbështetur në provat e administruara nga palët në proces, rezulton që ankuesja ka lidhur një kontratë punësimi me Qendrën “Çelësi im”, më datë 01.02.2018. Subjekti Qendra “Çelësi im”, referuar Ekstraktit Historik të shkarkuar nga regjistri i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), është një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me numër unik (NUIS) L.....A, me Administratore E. Sh..

Nga këqyrja e Kontratës së Punës, rezulton që ankuesja është punësuar në këtë subjekt për një afat të pacaktuar, në detyrën e koordinatorës së projektit, si dhe ka ushtruar edhe detyra të tjera si: gazetarë, përkthyes, mbikëqyrëse, moderatore etj.

Sipas informacionit të dhënë nga palët në proces, ankuesja gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, e në vijim, ka ushtruar detyrën e saj duke punuar nga shtëpia. Referuar të dhënave të cituara nga ankuesja, në ditë të caktuara të muajit, ajo paraqitej në ambientet e punëdhënësit për të kryer regjistrimet e emisioneve të ndryshme.

Më datë 05.12.2023, rezulton që nga ana e E. Sh., i është dërguar e-mail ankueses duke cituar ndër të tjera se: *“...Përveç programeve tona fillo të punosh këto programet. Ky është projekti i ri. Jemi duke punuar dhe në janar do të kalojmë full time me këtë. Edhe pak i komplikuar si projekt për ne se ka shumë elemente. Të lutem fillo ti punosh dhe më thuaj sa programe mund të punosh në javë nëse do të kishe vetëm këtë dhe nuk do të kishe programe të reja”*.

Nga të dhënat e administruara, më datë 12.12.2023, ankuesja është paraqitur pranë ambienteve të punës dhe ka marrë takime me Administratoren e Qendrës “Çelësi im”, E. Sh.. Gjatë këtij takimi, sipas informacionit të pranuar nga të dyja palët gjatë seancës dëgjimore, E. Sh. ka konstatuar që ankuesja po bashkëpunon me një shtetase amerikane, të quajtur K. A., e cila është drejtuese e një organizate të huaj CASMI.

Mbështetur në 2 publikime elektronike (newsletter), të depozituara edhe pranë Komisionerit, të muajit Maj 2024 dhe muajit Dhjetor 2023 të publikuara nga qendra CASMI, rezulton që ka foto të A. K. me përfaqësues dhe punonjës të ndryshëm të kësaj organizate. Gjithashtu në newsletter-in/publikimin elektronik të muajit Maj 2024, ndër të tjera i referohen A. K. si përkthyes, dhe citohet që kërkohen fonde për ta paguar atë për përkthimin dhe redaktimin e një libri.

Sa më sipër, gjatë diskutimit E. Sh., i është drejtuar ankuses, duke i kërkuar që ajo të vendos të punojë për Qendrën “Çelësi im” apo për zonjën amerikane. Në këtë moment, sipas ankuses, ajo ka kundërshtuar faktin që është vënë përpara një zgjidhje të tillë dhe është larguar nga ambientet e punës.

Në vijim, nuk rezulton të ketë patur asnjë komunikim me ankuses dhe përfaqësuesve të Qendrës “Çelësi im”, deri më datë 18.12.2023, ku përmes e-mail-it, E. Sh. i është drejtuar duke i kërkuar ndër të tjera: *“Uroj të jesh mirë. Të lutem që nesër dt. 19 dhjetor të paraqitesh në punë sipas orarit...”*.

Në përgjigje të e-mail-it sipër cituar, ankuesja i është drejtuar E. Sh., duke i theksuar se: *“Në bazë të bisedës që bëmë bashkë, të martën në dt. 12 dhjetor, ku më the të zgjidhja midis teje dhe Casmit, unë nuk punoj më për ju. Më the që do të shihje kontratën, për të vendosur për arsyen e largimit tim nga puna. Ndërkohë, mendërisht jam shumë e shqetësuar dhe nuk jam në gjendje të punoj. Ju lutem, plotësoni dokumentin përkatës.”*

Më pas, me e-mail E. Sh. i është drejtuar ankuses duke i parashtuar ndër të tjera se: *“Biseda që bëmë së bashku ditën e martë në datën 12 dhjetor nuk ishte mbarim i marrëdhënieve të punës dhe unë këtë ta bëra të qartë kur më pyete, nuk e kam kuptuar që paska qenë nga ana jote. Unë të thash që për vazhdimësinë do të të lajmëroj. Nuk e kam menduar që je larguar. Prandaj duke të kërkuar ndjesë që nuk e paskam kuptuar, do të të lutesha që të marr edhe një dorëheqje të nënshkruar prej teje për mbylljen e marrëdhënieve të punës duke qenë se ti paske vendosur të punosh për një punëdhënës tjetër pa më vendosur në dijeni. Nëse ke nevojë të të dërgoj një model dorëheqje, mund të ta dërgoj edhe unë, por nëse ke vetë, të lutem që të më dërgohet dorëheqja e firmosur nga ana jote për ta zyrtarizuar mbarimin e marrëdhënies sonë të punës dhe të vijojë secila me planet e veta.*

Do të të lutesha që nëse ti nuk punon më për Fondacionin Qendra “Çelësi im” që nga data 12 dhjetor, atëherë kjo datë të vendoset edhe në dorëheqje...”

Në përgjigje të saj, ankuesja përmes e-mail-it të së njëjtës datë, 18.12.2023, i sqaroi E. Sh. se: *“...Nuk e kuptoj gjithë këtë zell për të më detyruar mua të jap dorëheqjen, duke më trajnuar madje, edhe se si të jap dorëheqjen. Të siguroj se dorëheqjen as nuk e kam patur, dhe as nuk kam*

ndërmend ta bëj. Në rast se ti ke vendosur që, për çdo lloj arsye dhe faktorësh që janë jashtë kontrollit tim dhe qëllimit tim, që ti mi bërë të qarta në bisedën e datës 12 (për marrëdhënien time miqësore me K.), unë nuk duhet të vazhdoj të punoj për ju, të lutem ma bëj të qartë në mënyrë ligjore.

Për më tepër, të siguroj se kam qenë dhe jam në krye të detyrës, pavarësisht gjendjes sime të rënduar emocionale dhe psikologjike të këtyre ditëve të fundit (pas bisedës së datës 12)...

Në datën 20.12.2023, E. Sh. i është drejtuar sërish ankuses me e-mail duke i kërkuar ndër të tjera se: *“Duke filluar nga momenti që merr këtë e-mail, të lutem të paraqitesh në punë në orarin zyrtar çdo ditë të javës, 08:30-16:30. Ky komunikim anulon çdo komunikim të mëparshëm. Po të pres në zyre për të vazhduar punën si normalisht”.*

Në përgjigje të e-mail-it sipërcituar, ankuesja i është drejtuar E. Sh. duke i thënë se: *“Ashtu sikurse jeni njoftuar përmes sistemit e-albania, jam me raport mjekësor, data e fillimit dhe mbarimit të të cilit, është e qartë në të. Ju sugjeroj ta hapni dhe ta shihni. Ky raport është lëshuar nga mjeku përkatës, si pasojë e gjendjes sime, të shkaktuar nga biseda e datës 12 e ne vazhdim, me ty. Për sa i takon injorimit të bisedave, sikundër ti kërkon, kjo është e njëanshme, pra vetëm nga ty, pasi mua më ka shkaktuar një dëm të madh shëndetësor, të cilin nuk mund ta injoroj.”*

Sa më sipër, znj. K., përfaqësuese e Qendrës “Çelësi im”, i është përgjigjur duke i uruar të shkuara dhe duke i sqaruar se: *“...Të presim në dt. 3 janar”.*

Referuar provave të administruara, ankuesja nga data 19.12.2023 deri më datë 02.01.2024, është trajtuar me Raport për Paaftësi të Përkohshme në Punë, për të cilin është vënë në dijeni punëdhënësi.

Në vijim, ankuesja është trajtuar me Raport për Paaftësi të Përkohshme në Punë, nga data 02.01.2024, deri më datë 01.02.2024. Nga të dhënat e administruara, raporti i ankuses është gjeneruar në sistemin e-albania më datë 13.01.2024, në orën 03:13.

Qendra “Çelësi im” e ndodhur përpara faktit që nga ana e ankuses nuk kishte marrë një njoftim lidhur me pamundësinë shëndetësore për tu paraqitur në punë pas datës 03.01.2024, me shkresën datë 12.01.2024, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen. Në shkresën datë 12.01.2024, *“Komunikim në lidhje me përfundimin e kontratës së punës nga ana juaj”*, parashtrohet ndër të tjera se: *“Në vijim të komunikimeve tona në lidhje me marrëdhënien e punësimit ndërmjet jush dhe organizatës “Çelësi im” të rregulluara sipas kontratës individuale të punës, nënshkruar në datën 01.02.2018 ndërmjet jush dhe organizatës, duke qenë se ju nuk jeni paraqitur në punë, edhe pas përfundimit të raportit mjekësor që nuk e dorëzuat fizikisht, por e gjetëm në e-albania, bashkëngjitur nga data 03 janar 2024 ju konfirmojmë se e konsiderojmë kontratën të mbyllur në mënyrë të njëanshme nga ana juaj.*

Në përputhje me nenin 156 të Kodit të Punës, kontrata e punës nënshkruar në datën 01.02.2018 nga ana jonë quhet e zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga ju si punëmarrës në përputhje me Pikën 1 të Nenit 156 pasi nuk kemi asnjë njoftim nga ju për arsyet e mosparaqitjes në punë nga data

03.01.2024, datë kur ju duhet të ishit kthyer në punë pas përfundimit të raportit mjekësor bashkëngjitur

Ne e konsiderojmë braktisje të vendit të punës mosparaqitjen tuaj në punë pa asnjë shkak të arsyeshëm, të cilin nuk na e keni paraqitur në asnjë lloj forme komunikimi. Ne nuk kemi asnjë njoftim nga ju me shkrim në lidhje me shkaqet e arsyeshme të braktisjes së vendit të punës suaj dhe as ndonjë dorëheqje apo raport për arsyet e mungesës suaj në punë për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune.

Për këtë arsye, sot në datën 12.01.2024 duke e konsideruar braktisje nga ana juaj si punëmarrës vendin e punës dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se ne e konsiderojmë këtë zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës nënshkruar në datën 01.02.2018 nga ana juaj si punëmarrës.

Për më tepër dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se në përputhje me Pikën 2, të Nenit 156, ne nuk do të aplikojmë vlerë dëmi shtesë mbi mungesën tuaj, por thjesht pagën e javës së parë të janarit për të cilën ju nuk jeni paraqitur në punë për të vijuar marrëdhënien normale të punësimit⁴.

Në vijim, mbështetur në informacionin⁴ e marrë në faqen web të Postës Shqiptare, rezulton se Qendra “Çelësi im”, njoftimin e për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen e ka dorëzuar pranë Zyrës së Postës Tirana 5, më datë 13.01.2024, ora 11:09:00. Ndërsa, ankuesja është vënë në dijeni të shkresës së sipërcituar më datë 17.01.2024.

Sa i përket pretendimit të ankueses se nuk është lejuar nga punëdhënësi të punojë nga shtëpia, Komisioneri analizoi si më poshtë:

Neni 3, pika 3.3, i Kontratës Individuale të Punës, përcakton se: “Vendi i zakonshëm i punës së Punëmarrësit do të jetë selia e Punëdhënësit”.

Neni 15, “Puna në shtëpi dhe telepuna”, i Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar se: “1. Me kontratën e punës në shtëpi punëmarrësi kryen punën e tij në shtëpi, ose në ndonjë vend tjetër të përcaktuar në marrëveshje me punëdhënësin, sipas kushteve të rëna dakord midis tyre në kontratën e punës...”.

Nga të dhënat e administruara, sjellja e Qendrës “Çelësi im” kundrejt ankueses është konform kushteve të kontratës të punës dhe pa cenuar të drejtat e ankueses si punëmarrëse. Me provat e shqyrtuara vërtetohet se Qendra “Çelësi im” është treguar shumë fleksibël dhe mirëkuptuese ndaj disa kërkesave të ankueses për të punuar nga shtëpia si rezultat i gjendjes shëndetësore të saj, sjellje këto që dëshmojnë se Qendrës “Çelësi im”, nuk ka shfaqur sjellje diskriminuese dhe nuk ka abuzuar me cilësitë e saj si punëdhënëse.

Mbështetur në informacionin dhe provat e grumbulluara, rezulton se për Qendrën “Çelësi im”, veç ankueses nuk punonte asnjë punonjës tjetër nga shtëpia. Pra, ankuesja ishte e vetmja punonjëse që pavarësisht se në kontratën e punës ishte përcaktuar që vendi i punës është selia e punëdhënësit, ajo punonte nga shtëpia.

⁴ <https://eposta.postashqiptare.al/tracking/RR564124491AA>

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se referuar në aktet e sipërcituara rezulton se kërkesa e punëdhënësit drejtuar ankueses për tu rikthyer dhe punuar nga selia e punëdhënësit, është e mbështetur në Kontratën Individuale të Punës dhe Kodin e Punës.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Qendrës “Çelësi im”, nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme lidhur me sa ka pretenduar ankuesja, sa i përket rikthimit të saj për të punuar nga selia e punëdhënësit.

- *Lidhur me pretendimin e ankueses për zgjidhje të marrëdhënieve të punës.*

Neni 153, i Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar se:

- “1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*
- 2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohej atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës”.*

Neni 156, pika 1, e Kodit të Punës, ka përcaktuar se:

“1. Kur kontrata e punës zgjidhet nga punëdhënësi, për arsye se provohet se punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë, pa shkaqe të arsyeshme, dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar, me shkrim, punëdhënësin, ajo konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar e kontratës së punës nga ana e punëmarrësit. Punëmarrësi duhet të përgjigjet financiarisht ndaj punëdhënësit, jo më shumë se paga e një jave. Ai duhet të përgjigjet edhe për dëmin shtesë, që është diferenca midis dëmit dhe pagës së një jave.”.

Komisioneri, bazuar në kronologjinë e ngjarjeve, faktet e rrethanat e analizuar, vlerëson se:

- Referuar analizës së bërë parashtrimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, rezultoi se biseda e zhvilluar mes E. Sh. dhe ankueses, kishte të bënte me faktin që ajo i kërkonte të vendoste të punonte për Qendrën “Çelësi im” ose për shtetasen amerikane. Nga informacioni i administruar, biseda lidhej me marrëdhëniet e punësimit dhe jo me marrëdhëniet personale;
- Nga analiza e bërë korrespondencës së mbajtur mes ankueses dhe Qendrës “Çelësi im”, evidentohet se në asnjë moment nga ana e qendrës nuk i është kërkuar A. K. të zgjidhë marrëdhëniet e punës apo të jetë vënë përpara detyrimit për tu larguar nga puna. Madje, referuar komunikimeve të zhvilluara përmes e-mail-eve të datës 18.12.2023, evidentohet se A. K. ka vënë në dijeni punëdhënësin se nuk do të punonte më për të;
- Nga provat e administruara, Qendra “Çelësi im”, nuk ka marrë dijeni lidhur me mos paraqitjen në punë të ankueses për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune. Fakti që nga data 02.01.2024 deri më datë 13.01.2024, ankuesja nuk ka marrë asnjë veprim për të njoftuar punëdhënësin, siç parashikohet edhe në legjislacionin sipërcituar, lidhur me mos paraqitjen e saj për arsye shëndetësore në vendin e punës, ka bërë që nga ana e Qendrës “Çelësi im”, të merret masa e zgjidhjes së pajustificuar të kontratës së punës.

Kontrata e punës është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit që ka fuqinë e ligjit, rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Kontrata Individuale të Punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit ka parashikuar gjithashtu se, punëdhënësi dhe punëmarrësi në çdo kohë mund të zgjidhin kontratën e punës për shkaqe të justifikuara. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara, sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohej atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënies së punës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara, në favor të punëdhënësit, rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, siç është rasti i mungesës së paarsyeshme të ankuesit në punë dhe pa lajmëruar punëdhënësin për arsyet e saj.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Qendrës “Çelësi im” nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen, dhe se kjo masë, si pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore është marrë proporcionalisht me natyrën e shkeljes.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Qendrës “Çelësi im”.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Qendrës “Çelësi im”, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e pretendimit të paraqitur nga A. K. kundër Shoqërisë Media J-7, lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkaqet e pretenduara në ankesë, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të A. K., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana e Qendrës “Çelësi im”, në të drejtën për punësim.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore)

(Fusha: Punësim)